

Ritmi

a) Ritmi natyral i gjuhës quhet **kadencë**. Ajo merr formë nëpërmjet *theksit të fjalëve, gjatsisë së zanoreve, intonacionit*, dhe aspekteve si: *sa konstrukte bashkëtingllorsh* lejon një gjuhë e caktuome në fillim ose fund të fjalës, *sa bashkëtingllore* mund të dalin në mes dy zanoresh, *cilët tinguj dalin më shpesh*, në çfarë raporti qendrojnë zanoret me bashkëtinglloret, *cilët tinguj nuk lejohen të pasojnë disa tinguj specifikë*, etj.

Në shqip, ritmi ndikohet edhe prej përdorimit të shvasë zbutëse, e cila mund të mbipërdoret ose nënëpërdoret.

b) Në qoftë se ritmi natyral i gjuhës është ritmi i ecjes, atëherë **ritmi artistik** do të ishte ritmi i vallzimit ose kërcimit. Ashtu si koreografi përcakton ritmin e hapave të valltarit, edhe shkruesi përcakton ritmin e tekstit.

c) Kadenca dhe ritmi artistik janë të randsishëm, por jo aq sa **ritmi i jetës**, p.sh., *rrahjet e zemrës, gurgullimi i ujit, zhurma e qytetit, qesia e katundit, madhshtia e Alpeve*. Po ashtu, tjetër ritëm kanë mendimet e qeta, tjetër të eksituomet; tjetër ritëm ka mendja që e kupton diçka qartazi, tjetër mendja që s'e kupton diçka.

ç) Ritmi varet edhe prej modalitetit. Theksi, gjatsia e zanoreve, shvaja zbutëse, dhe pushimi, i shërbejnë më s'miri poezisë. Kurse ritmi i krijuom nëpërmjet fjalive komplekse dhe frazave modifikuese i shërben më s'miri prozës fiktive.

d) Nëpërmjet ritmit, autori kontrollon frymmarrjen e lexuesit. Një fjalë e gjatë e detyron lexuesin ta mbajë frymën. Kurse një seri fjalish të shkurta e detyrojnë lexuesin ta përshpejtojë frymmarrjen. Megjithatë, secila ka vendin e vet; e para mundson meditim, e dyta krijon tendosje.

Më e randsishëmja është që ritmi i tekstit të përkojë me botën që teksti përshkruan. Kur kjo ndodhë, lexuesit i duket sikur është pjesë e ritmit të jetës së përshkruome në tekst.

Theksi dhe Kronemat (Fizika e Zanit)

a). Në gjuhën shqipe, theksi ka tri shkallë: 1) kryesor, 2) dytsor, dhe 3) pa theks. Theksi kryesor është i fortë. Ai mund të gjindet në cilëndo rrokje, por zakonisht del në rrokjen parafundore. Gjatë eptimit theksi mbetet në të njëjtën rrokje, p.sh., *vjëlë, vjéli, vólën*.

Tipikisht, theksi zhvendoset në prapashtesa, p.sh., *argjendár, argjendárët > argjendaría*.

b) Me 'kronemë' kuptohet duresa e nyjtimit të një tingulli, kryesisht, zanoreve, p.sh., lidhëza: *dhë* vs. emëni: *dhë*. Ka tri kronema: *të shkurta, të mesëme, dhe të gjata*. At mund të përdoren edhe me dallua fjalët prej njëna-tjetrës, p.sh.,

pã ujë; pã ujë: Pas tri ditësh *pa ujë* u eksitua kur *pa ujë* të kthjellët.

ka një ka: Ai ka një ka të shpejtë.

Shkallët e gjatsisë së zanoreve janë relative sepse ato ndryshojnë në varsi prej rrethanave kumtore. Gj. Shkurta arsyeton kështu: *Zanoret e gjata në emnat e pashquom zã, pë* kthehen në të mesëme kur këta emna shquhen, p.sh., *zã/záni, pë/peni*. Në trajtën e pashquome, zanoret në rrokjen sostore të emënave *Sokol* dhe *çak* dalin me duresë të shkurtë, kurse në trajtat e shquome të njëjëtat zanore dalin me duresë të mesëme, *Sokóli, cáku*.

Shvaja (Kadenca dialektore)

Gjuha shqipe ka dy tinguj ‘ë’. Njëni sish është tingull zbutës. Ai quhet shva. Përdorimi i tij ndryshon në varsi prej dialektit. Tipikisht, a) toskët e mbipërdorin atë, b) folësit e Shqipnisë së Mesëme, malsive gege, dhe veçsisht Kosovës, e nëpërdorin atë, ndërsa c) ndër folësit e veriperëndimit, përdorimi i tij del i balancuom, p.sh.: /në *Durrës/*, /n’*Durrc/*, /në *Duurrs/*.

Stakato dhe Legato (Dinamika e Aksionit)

Ritmi artistik mund të krijohet edhe nëpërmjet vëmjes së fjalëve a frazave në ndërkohsi të caktuome, si edhe nëpërmjet lojës me gjatsinë a shkurtsinë e zanoreve, fjalëve, frazave, klauzave, dhe fjalive.

Me përçua aksion të shpejtë e te mprehtë, përdoren fjalí të thjeshta e të shkurta, që kanë ritëm te qartë dhe kulminativ (klimaksor). Kulmi ka vlerë semantike, kur ai sosë më koncepte më të randsishëme, dhe shpejtsí kur fjalitë dalin gjithnjë e më të shkurta ndërsa ato i afrohen sosjes (qyenit). Në trillsí (en. fiction), ky ritëm tregon veprime të njëpasnjëshëme dhe të pandalëshme. Në jotrillsí (en. nonfiction) mund të flitet për të vërteta të padiskutueshëme.

Moslidhja e Fjalive (it. staccato)

Fjalitë mund të jenë të shkurta, por ato edhe mund të shkurtohen duke u shpëputë prej njëna-tjetrës, p.sh., duke u heqë lidhëzat.

Fjalitë e shkurta krijojnë imazhin e përsheptimi, por ato duhet të jenë të pakta, përndryshe pjesa do të përfntonte një ritëm marshimi. Gjithashtu, ato duhet të kontrastohen me fjalí të gjata, përndryshe do të ishte e vështirë me bâ dallim

Fjalitë e shkurta dhe të gjata mund të konceptohen si batica e zbatica; sikur ato shtyjnë njëna-tjetrën. Kjo gjendje lëkundieje e bân më të lehtë kalimin në fjalí të shkurta kur ato përkojnë me ritmin e jetës në botën e rrëfimit.

Shembull: *Gruaja kishte mbetun shtang. Qeni lehte, por ajo s’e dëgjonte. Dikur, pa vetdije, ajo ngriti dorën dhe tundi bekurat. Qeni u turr. Ajo pas tij. La gjithçka.*

Në këto rreshta, qëllimi i autorit është me ngritë emocionet. Fjalía sostore ‘la gjithçka’ i jep fund rrjedhës së ligjratës.

Lidhja e Fjalive (it. legato)

Ndryshe prej fjalive të përshpejtuome, fjalive që rrjedhin natyrshëm nuk u hiqen fjalët lidhese. Kjo ndihmon në ngadalsimin e rrëfimit, çka i jep mundsi lexuesit të reflektojë më thellë. Kështu, jo vetëm gjatsia e fjalive, jo vetëm ruajtja ose heqja e fjalëve lidhese, por edhe kumti semantik që përçon fjalitë ndryshon – sepse mundsohet meditimi ose thellimi. Në fjalitë të përshpejtuome cakohet me ndezë emocionet. Në fjalitë që rrjedhin natyrshëm cakohet me u thellua në arsyetim.

Shembull: *Gruaja kishte mbetun shtang, ndërsa qeni lehte, por të cilin ajo s'e dëgjonte. Dikur, pa vetdije, ajo ngriti dorën dhe tundi hekurat. Qeni u turr dhe ajo shkoi pas tij, duke lanë gjithçka.*

Se cili tip fjalie zgjidhet, varet prej autorit. Por mjeshtria e të shkruomit kërkon që ritmi i tekstit t'i përshtatet *kadencës* së gjuhës, *stilit* të autorit, dhe veçsisht *ritmit të jetës*; rrahjet e zemrës kur vrapon pas qenit të hekurave janë më të shpeshta sesa rrahjet e zemrës kur qendron shtang. Pyetja është, *si e tregon autori këtë ndryshim pa kalua në arithmetikë?*

Vizualizimi i ritmit në skenë a ekran

Në fund të fjalive ka një pikë. Në skenë a ekran, kjo pikë përfaqsohet prej një pushimi ku aktori merr frymë. Në fjalitë të gjata (legato), pushimi dhe frymmarrja janë të mundshme. Autori paraqitet në kontroll të vetvetes, dhe kështu duket autoritar. Në një tekst *legato*, pika është fundi i një periudhe të gjatë ku aktori shkarkon frymën me autoritet; sikur shlodhet sepse shprehu një mendim të menduom thellë.

Në një seri fjalish të shkurta, frymmarrja përshpejtohet. Aktorit nuk i jepet kohë e mjaftueshme as me marrë frymë as me shprehë mendimet. Prandaj, ai paraqitet i tensionuom. Në një tekst *stakato*, pika nuk është fundi i mendimit, por një pushim ku aktori përpiqet të përmbledhi tensionin.